



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 336

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË SUBJEKTIT
VETËDEKLARUES Z. AFRIM ALI KICA, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN BASHKIAK I
PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT" PËR BASHKINË
TIRANË**

Sot më datë 12.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Afrim Ali Kica, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Lëvizja e Legalitetit", për Bashkinë Tiranë.

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 5 dhe 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen,

Data: 12.4.2023 Nr: 336
Ora: 12:00



"Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Afrim Ali Kica, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Lëvizja e Legalitetit" për Bashkinë Tiranë".

emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtarë në këshillat bashkiak.

Me vendim të KQZ-së, z. Afrim Ali Kica, është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Tiranë, i mbështetur nga subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”.

Për këtë kandidat në datën 27.3.2023, pranë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është depozituar formulari e vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik TR-PLL-3546. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPGJ).

Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, DPGJ informon se kandidati në fjalë nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Afrim Ali Kica, rezulton:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se nuk ka ndryshim tek gjeneralitetet e tij;
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjë here me vendim gjyqësor të formës së prerë”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se është proceduar nga Gjykata Komunale e Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 211 Akti datë 30.1.2011, për veprën penale të parashikuar nga nenet 228,229,259 dhe 238 të K.Pr.Penale; Kandidati ka deklaruar se është proceduar nga Gjykata Komunale në Dubrovnik me nr. Zyrtar 14-K,572/14, me masë dënimi 2 vite kusht, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 278 paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 i K.Penal;
- Pyetjes 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoriteti i huaj, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”. Duke deklaruar se është proceduar nga Gjykatën Komunale, Dubrovnik, për kalim kufiri ne periudhën 13.12.2014 dhe është dënuar me 2 vjet kusht.
- Pyetjes 4 “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar është proceduar penalisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me akuzë për prishjen e rendit publik në datë 27.1.2011 dhe është deklaruar i pafajshëm.
- Pyetjes 5 “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO” duke deklaruar se është proceduar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë akuzuar për veprën penale te parashikuar nga neni 80 dhe 25 i K.Penal me vendimin nr. 77 datë 16.2.2011 në periudhën 30.1.2011 deri më 16.2.2011. Subjekti është proceduar nga Ministria e Mbrojtjes Civile në shtetin Grek Athinë, për çështjen civile të parashikuar nga neni 82, ligji 3386/05 me karakter civil me nr.4/1062027

datë 10.05.2016 për periudhën 11.05.2009 -10.05.2016.

Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve si më sipër në formular, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja. Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve , nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Afrim Ali Kica kandidat për anëtar në këshillin bashkiak i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit” për Bashkinë Tiranë dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI